



Në bazë të nenit 34, 35 dhe 46 të Ligjit mbi planifikimin dhe rregullimin e hapsirë ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 2/89), nenit 3 të Rregullorës mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000 dhe nenit 40 alinea 3 pika 2 të Statutit të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me 27.02.2003, merr

**V E N D I M**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR MIRATIMIN E**  
**PLANIT DETAL URBANISTIK TË KOMPLEKSIT TË FAKULTETIT TEKNIK**  
**NË PRISHTINË**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për miratimin e Planit Detal Urbanistik të kompleksit të Fakultetit Teknik në Prishtinë, i shpallur në ("Gazetën Zyrtare të Kosovës" nr. 16/75).

**Neni 2**

Pjesës së ngastrës kadastrale nr. 2734/1 Komuna Kadastrale e Prishtinës, i ndryshohet destinimi, nga ai i paraparë si hapsirë për gjelbrim, në hapsirë për ndërtimin e objektit të Nënstacionit shkëmbyes me fuqi 20MW .

Ndërmarrjes Komunale Publike për Termofikim "TERMOKOS" nga Prishtina, i jepet në sfhrytëzim të përkohëshëm sipërfaqja e tokës prej 200 m<sup>2</sup>, e evidentuar si pjesë e ngastrës kadastrale nr. 2734/1 në kohëzgjatje prej 10 vitesh për ndërtimin e objektit nga alinea 1. e këtij neni, me mundësinë e vazhimit të kësaj të drejte edhe pas kalimit të këtij afati.

Pjesë përbërëse e vendimi mbi ndryshimin dhe plotësimin e këtij plani është pjesa tekstuale dhe ajo grafike.

**Neni 3**

Bartës i detyrës për ndryshimin e këtij Vendimi nga aspekti i ndryshimit të pjesës tekstuale dhe grafike të elaboratit të Planit Detal Urbanistik nga neni 1. i këtij Vendimi është Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës, ndërsa Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, do të kryej veprime procedurale nga përgjegjësia e tij.

**Neni 4**

Bazë për pregaditjen e dokumentacionit teknik për realizimin e projektit për ndërtimin e objektit në fjalë janë kushtet urbanistike-teknike si pjesë përbërëse e këtij plani.

**Neni 5**

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Bordi i Drejtorëve të Komunës së Prishtinës.

**Neni 6**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.NR.350-268 DT.04.03.2003**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**

ARSYETIM  
I PROPOZIM VENDIMIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR  
MIRATIMIN E PLANIT DETAL URBANISTIK TË KOMPLEKSIT TË FAKULTETIT  
TEKNIK NË PRISHTINË

Ndërmarrja Komunale Publike për Termofikim "TERMOKOS" nga Prishtina me kërkesën nr. 011-352-1021 të datës 28.05.2002 i është drejtuar Drejtoratit për Shërbime Publike, Transport dhe Mbrojtje të Ambientit, për lejimin e ndërtimit të objektit të nënstacionit shkëmbyes me fuqi 20 MW në kompleksin e Fakultetit Teknik të Prishtinës.

Drejtorati për Shërbime Publike, Transport dhe Mbrojtje të Ambientit kërkesën e përmendur e ka përcjellë në Drejtoratin e Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë për dhënien e pëlqimit urbanistik për ndërtimin e objektit të kërkuar.

Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë pas shqyrtimit të kërkesës dhe planeve detale urbanistike të kompleksit ku është kërkuar lejimi i ndërtimit ka konstatuar se dhënia e pëlqimit për ndërtimin e një objekti të tillë nuk ka mundë të bëhet nga shkaku se me planin detal urbanistik të asaj hapsire lokacioni i kërkuar ka destinim tjetër përkatësisht është i destinuar si hapsirë për gjelbrim.

Prandaj, në mënyrë që të zgjidhet kjo kërkesë, konform me rregullativën ligjore nga lëmia e planifikimit dhe rregullimit hapsinor, është e domosdoshme që paraprakisht të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i planit detal urbanistik ekzistues përkatësisht të ndryshohet përmbajtja-destinimi i paraparë me atë plan kështu që, ky Drejtorat pas konsultimeve paraprake dhe pëlqimeve nga Bordi i Univerzitetit të Prishtinës nr. 430 të datës 07.08.2002 pregaditi propozim vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e planit detal ekzistues.

Arsyeshmëria e ndryshimit të planit dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të kërkuar, pos nga arsyet e përmendura, qëndron edhe në faktin se ndërtimi i një nënstacioni të tillë është më se i domosdoshëm për furnizimin e mjaftueshëm me ngrohje të lagjës "Kodra e Diellit" si dhe për ndërtimin e objektit në fjalë janë alokuar mjete financiare nga Bashkësia Evropiane nëpërmes Agjencionit Evropian për Rekonstruim.